

- Sekretarit i Përgjithshëm;
- Departamentit ligjor;
- Departamentit të PSSh;
- Arkivit të MSh-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
National Institute of Public Health of Kosovo

UDHËZUES
PËR
VLERËSIMIN E PËRBASHKËT TË RISKUT ME
QASJE
“NJË SHËNDET”

Prishtinë, 2026

PËRMBAJTA

Hyrje	3
Si të përdoret Udhëzuesi për Vlerësim të përbashkët të riskut	4
Vlerësimi i riskut, 2023 në Kosovë sipas veglës STAR	7
1. Moduli 1 “Organizimi”	8
2. Moduli 2 “Korniza e riskut”	9
3. Moduli 3 “Zbatimi”	10
4. Moduli 4 “Përdorimi i rezultateve”	20
5. Anekset	23

UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E PËRBASHKËT TË RISKUT ME QASJE “NJË SHËNDET”

Hyrje

Me Vendimin nr. 47/II/2026 të datës 10.02.2026, është themeluar grupi punues për hartimin e Udhëzuesit për vlerësim të përbashkët të riskut me qasje “Një Shëndet”. Ky Udhëzues derivon nga Plan i parandalimit, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen për pandemitë me patogjen respiratorë, Objektiva 2. Mbikëqyrja e integruar në harmoni me qasjen “Një shëndet”, aktiviteti 2.15.

Udhëzuesi për vlerësim të përbashkët të riskut (VPR), dokument ky i përgatitur duke u referuar në dokumentin e OBSH-së, “*Joint risk assesment operational tool*” *An Operational Tool of the Tripartite Zoonoses Guide*, WHO 2020,¹ është dokument ndërsektorial i cili ka për qëllim të shfrytëzohet nga të gjitha grupet ndërsektoriale të interesit, si në nivel vendi ashtu edhe në atë regjional me qëllim të përcaktimit të procedurave, përgjegjësisve dhe hapave konkret për vlerësim të riskut.

Sëmundjet zoonotike, endemike dhe rishfaqja e tyre, përbëjnë rrezik si për shëndetin e njeriut, të kafshëve dhe në përgjithësi për shëndetin publik. Në kontekstin e ndërveprimit në mes të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit, rreziqet shëndetësore nuk mund të trajtohen më në mënyrë sektoriale, por kërkojnë qasje të integruar ndërinstytucionale. Sëmundjet zoonotike, shpërthimet me origjinë ushqimore, rezistenca antimikrobike, ndryshimet klimatike, përmytjet, ndotja mjedisore dhe tubimet masive paraqesin sfida që tejkalojnë kufijtë institucionalë. Aktivitetet për identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe zvogëlimin e rreziqeve nga sëmundjet zoonotike varen nga koordinimi dhe bashkëpunimi midis ministrive dhe agjencive dhe institucioneve tjera brenda vendit të cilat janë përgjegjëse për shëndetin e njeriut, shëndetin e kafshëve dhe mjedisit. Edhe pse është e rëndësishme që sektori i shëndetit të njeriut, të kafshëve dhe sektorë të tjerë të kryejnë vlerësimet e tyre për të menaxhuar rreziqet brenda kontekstit të secilit sektor, bashkimi i informacioneve dhe ekspertizës nga të gjithë sektorët përkatës, për të vlerësuar së bashku rreziqet shëndetësore nga sëmundjet zoonotike është i nevojshëm për të kuptuar dhe menaxhuar plotësisht rreziqet e përbashkëta ndaj njeriut–kafshës–mjedisit. Kur sektorët e përfshirë kontribuojnë me të dhëna, njohuri dhe ekspertizë në vlerësim, sasia dhe cilësia e informacionit të disponueshëm për të vlerësuar rreziqet është qenësore dhe me vlerë.

Suksesi i vlerësimit të përbashkët të riskut varet nga komunikimi ndërmjet sektorëve për gjatë gjithë procesit, përmes konsensusit mbi rezultatin e vlerësimit dhe hartimin e dokumentit të vlerësimit të përbashkët. Ky është proces që përsëritet në mënyrë periodike, i cili përfshin diskutime mbi opsionet e menaxhimit të riskut, nevojat për komunikim (analiza e riskut), dhe ofrohen rekomandime. Kjo mundëson vendimmarrësit të marrin dhe të zbatojnë masa të menaxhimit të riskut bazuar në të dhëna shkencore dhe mesazhe komunikimi të harmonizuar ndërmjet sektorëve ose të zbatuara së bashku.

Me qëllim të funksionimit optimal, hapat e duhur janë si në vijim: **Angazhimi politik:** Angazhimi, mbështetja dhe vullneti politik mund të lehtësojë mbledhjen e sektorëve përkatës për të marrë pjesë në proces dhe për të optimizuar rezultatet dhe dobishmërinë e vlerësimit. Megjithatë, edhe kur një mbështetje e tillë politike nuk është e disponueshme, ekipet teknike përgjegjëse për zoonozat mund të bashkohen në funksionet e tyre të ndryshme për të përfunduar një vlerësim të përbashkët.

¹ <https://www.who.int/initiatives/tripartite-zoonosis-guide/joint-risk-assessment-operational-tool>

Angazhimi në sektorin relevant: Disa sëmundje zoonotike prekin kryesisht njerëzit, por jo kafshët, ose kafshët e egra por jo bagëtinë. Pavarësisht ndikimit në një sektor, informacioni dhe ekspertiza nga të gjitha grupet e palëve të interesit është e nevojshme për të vlerësuar plotësisht rreziqet.

Qasja në informacion: Shpesh, herët në një ngjarje nuk ka informacion të mjaftueshëm dhe një nivel të lartë pasigurie rreth rezultatit të një vlerësimi të riskut. Pavarësisht informacionit të disponueshëm, një vlerësim risku identifikon boshllëqe specifike të informacionit dhe aktivitetet e synuara për mbledhjen e tij.

Si të përdoret Udhëzuesi për Vlerësim të përbashkët të riskut

Ky Udhëzues i dedikohet stafit nga institucionet përgjegjëse për shëndetin e njeriut, shëndetin e kafshëve dhe mjedisin, ose agjencive të tjera qeveritare përgjegjëse për kontrollin dhe menaxhimin e sëmundjeve zoonotike, si epidemiologëve, stafit laboratorik human, animal dhe mjedisor, menaxherëve të riskut dhe ekspertëve të komunikimit. Udhëzuesi ofron udhëzime për vlerësim cilësor të riskut të përbashkët, procesin e vlerësimit dhe përshkruan hap pas hapi se si të kryhet secili komponent i këtij procesi.

Parimet e vlerësimit të riskut

Vlerësimi i riskut është procesi sistematik i mbledhjes, vlerësimit dhe dokumentimit të informacionit për të përcaktuar nivelin e riskut për një periudhë dhe vend të caktuar. Është një proces periodik i bazuar në informacionin e disponueshëm gjatë vlerësimit. Risku përbëhet nga dy komponente: mundësia (probabiliteti) dhe ndikimi (pasojat, impakti), dhe çdo element matet për shkallën e pasigurisë.

- Mundësia është probabiliteti i vlerësuar ose shansi që situata në pyetjen e vlerësimit të riskut të ndodhë.
- Ndikimi përshkruan nivelin ose ashpërsinë e pasojave nëse ajo situatë ndodh.

Vlerësimet e riskut (duke marrë parasysh si probabilitetin/mundësinë ashtu edhe ndikimin/impaktin) varen nga rreziku i dyshuar ose i njohur, prania ose ekspozimi i mundshëm ndaj riskut, dhe konteksti për të vlerësuar ngjarjen. Vlerësimet e riskut mbështeten në njohuritë aktualisht të disponueshme, të cilat zakonisht janë të paplota ose të vështira për t'u verifikuar, prandaj ato gjithmonë përfshijnë një tregues të pasigurisë mbi vlerësimin e riskut në rezultatet/raportin. Pasiguria varet nga cilësia dhe detajet e informacionit në dispozicion në kohën e vlerësimit.

Vlerësimet e riskut mund të jenë sasiore ose cilësore.

Në vlerësimet sasiore të riskut, probabiliteti, ndikimi dhe pasiguria shprehen duke përdorur numra. Të dhënat që mungojnë vlerësohen duke përdorur modele matematikore ose përmes konsultimeve me ekspertë. Megjithatë, shpesh nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të kryer vlerësime sasiore të vlefshme. Këto vlerësime janë më të shpejta, kërkojnë më pak informacion të plotë dhe përdorin opinionin e ekspertëve nëse mungojnë të dhëna shkencore.

Vlerësimet cilësore të riskut vlerësojnë ngjarjet shëndetësore ose emergjencat ku të dhënat janë të kufizuara ose kërkohet një përgjigje e shpejtë.

Roli i vlerësimit të riskut në menaxhimin e riskut

Vlerësimet e riskut ofrojnë dëshmi për vendimet mbi menaxhimin e riskut dhe komunikimin e riskut. Vlerësimet e riskut lidhin drejtpërdrejt rezultatet me vendimet e menaxhimit. Prandaj, proceset e vlerësimit të riskut funksionojnë më mirë brenda strukturave qeveritare që mbështesin menaxhimin e

riskut dhe komunikimin e riskut, duke përfshirë vendimmarrësit dhe politikanët nga të gjitha sektorët e rëndësishëm.

Vlerësimet e rreziqeve specifike për sektorin janë mënyra të rëndësishme për sektorët e shëndetit të njeriut, shëndetit të kafshëve dhe mjedisit për të menaxhuar rreziqet që lidhen me sektorin e tyre brenda kontekstit, prioriteteve dhe mandatit të sektorit, për shembull nëse nevojiten shtretër shtesë në spital ose nëse duhet të forcohet kontrolli mbi lëvizjen e kafshëve. Këto vlerësime specifike për sektorin janë thelbësore dhe duhet të zhvillohen për të gjitha ngjarjet dhe kërcënimet e sëmundjeve zoonotike. Për sëmundjet me lidhshmëri njeri–kafshë–mjedis, sektorë dhe disiplina të ndryshme duhet të punojnë së bashku.

Sfida kryesore për kryerjen e vlerësimit të përbashkët janë dallimet midis sektorëve bazuar në nevojat e tyre, prandaj edhe pyetjet e vlerësimit të riskut ndryshojnë. Mjetet dhe proceset që përdorin sektorë të ndryshëm për vlerësimin e riskut evoluojnë për të përmbushur nevojat e tyre dhe nuk përputhen drejtpërdrejt me ato të sektorëve të tjerë.

Kur të bëhet një Vlerësim i Përbashkët i Riskut?


Vlerësimet e përbashkëta të riskut kryhen:

- pas prioritizimit të sëmundjeve zoonotike;
- rregullisht për planifikimin e emergjencave;
- gjatë një situatë emergjente.

Hapat e rekomanduar sipas procesit të Vlerësimit të përbashkët të riskut janë 10, siç shihet në figurën. 1.

Ky Udhëzues përcakton kornizën për vlerësimin e përbashkët të riskut dhe është i harmonizuar me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit (IHR 2005).

Figura 1. Modulet e Vlerësimit të Përbashkët të Riskut dhe hapat: obligativ (me ngjyrë të kuqe) , rekomanduar: (e zezë).



Vlerësimi i riskut, 2023 në Kosovë sipas veglës STAR

Në Republikën e Kosovës, një numër i konsiderueshëm i kërcënimeve prioritare të shëndetit publik janë të lidhura drejtpërdrejt me qasjen njeri–kafshë–mjedis. Sipas rishikimit të Vlerësimit të Riskut të vitit 2023 të realizuar me përdorimin e mjetit vlerësues STAR të OBSH-së janë identifikuar dhe vlerësuar veç e veç njëzet e gjashtë (26) rreziqe, të cilat u përmbledhën në njëzet e katër (24) sosh. Sipas kategorive si: gjeofizike, që ndërlidhen me motin, industriale/teknologjike, shoqërore dhe biologjike². U identifikuan dhe u vlerësuan në mënyrë individuale njëzet e gjashtë rreziqe, të cilat më pas u përshtatën në njëzet e katër sosh. Këtu janë përfshirë disa kategori si ato: gjeofizike, që ndërlidhen me motin, industriale/teknologjike, shoqërore dhe biologjike. Rreziqet biologjike u klasifikuan në sëmundje feko-orale (Diarrhea akute ujore, Gastroenterit/Sëmundje të shkaktuara nga ushqimi dhe Poliomieli), rreziqe tjera infektive (Rezistenca ndaj antimikrobikëve dhe Sëmundja X), sëmundje të cilat përhapen përmes ajër-it/spërklave (patogjenë të frymëmarrjes me potencial të shkaktojnë pandemi si Gripi, Koronavirusi, Ortopoks virusët, COVID-19 dhe fruthi), kontakti kafshë-njeri (zoonoza), (leptospiroza, tularemia dhe bruceleza), ethet hemorragjike virale (VHFs) (ethet hemorragjike me sindromën renale (EHSR), Ethet hemorragjike- Krime Kongo (EHKK) dhe në fund sëmundjet që transmetohen nga vektorët (ethet e Nilit Perëndimor). Rreziqet jo-biologjike gjithashtu u klasifikuan në ato që ndërlidhen me motin (vërshimet dhe orteqet), gjeofizike (tërmetet), mjedisore (ndotja e ajrit dhe zjarret), teknologjike (bërthamore, biologjike, rrezatimi dhe agentët kimikë) dhe shoqërore (trazirat civile).

Në përgjithësi, asnjëra nga këto rreziqe nuk është klasifikuar si rrezikshmëri shumë e lartë, shtatë rreziqe u renditën si rrezikshmëri e lartë, gjashtë nga to si rrezikshmëri mesatare, dhjetë si rrezikshmëri e ulët dhe asnjëra nga këto rreziqe nuk është klasifikuar si rrezikshmëri shumë e ulët.

Ndotja e ajrit, diarreja akute ujore, sëmundjet/gastroenteritet e shkaktuara nga ushqimi, agentët kimikë, të rrezatimit bërthamor, si dhe vërshimet janë identifikuar si rreziqe me prioritet të lartë. Kjo ndërlidhet me pashmangshmërinë e shfaqjes së tyre, potencialin për transmetim, shkallën e lartë të fataliteteve dhe kapacitetet e kufizuara përballuese për ti menaxhuar këto incidente. Në anën tjetër, zjarret në pyje, rezistenca ndaj antimikrobikeve, patogjenët e frymëmarrjes që potencialisht mund të shkaktojnë pandemi, COVID-19 dhe tërmetet u konsideruan si ngjarje me prioritet mesatar, megjithëse cenueshmëritë dhe kapacitetet përballuese për menaxhimin e këtyre ngjarjeve ndryshojnë shumë.

Besueshmëria e përgjithshme gjatë vlerësimit të rrezikshmërisë u përcaktua të jetë e lartë duke u bazuar në nivelet e besueshmërisë të përcaktuara për secilin rrezik. Cenueshmëria dhe kapacitetet përballuese për secilin rrezik u diskutuan detajisht nga dy nëngrupet punuese për rreziqet biologjike dhe jobiologjike.

Në përgjithësi, asnjëra nga këto rreziqe nuk është klasifikuar si rrezikshmëri shumë e lartë, shtatë rreziqe u renditën si rrezikshmëri e lartë, gjashtë nga to si rrezikshmëri mesatare, dhjetë si rrezikshmëri e ulët dhe asnjëra nga këto rreziqe nuk është klasifikuar si rrezikshmëri shumë e ulët. Matrica aktuale e riskut në Kosovë dhe përmbledhja e riskut janë të ilustruara në Raportin Teknik – të Rezultateve të Vlerësimit Strategjik të Rreziqeve në Kosovë.

² Ministria e Shëndetësisë. Raporti Teknik i Rezultateve të Vlerësimit Strategjik të Rreziqeve në Kosovë. Prishtinë.

1. Moduli 1 “Organizimi”

Hapi 1 dhe 2

1.1 Komiteti Një shëndet dhe emërimi i kryesuesit

Në përputhje me Ligjin për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse në Kosovë, Nr.08/L-200, respektivisht nenin 10 të këtij Ligji, Organet kolegjiale, paragrafi 1.8. është themeluar Komiteti për shëndetin human, animal dhe mjedisor “Një shëndet”.

Mandati kryesor i Komitetit për shëndetin human, animal dhe mjedisor “Një shëndet” është që veprimtarinë e vet ta zhvillojë konform Ligjit për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse nr.08/L-200. Të adresojë në mënyrë të përbashkët sfidat që paraqiten në Kosovë, të identifikojë zgjidhjet dhe intervenimet më të mira dhe të promovojë veprimet efektive ndërsektoriale duke shfrytëzuar ekspertizën nga fushat shëndetësore, veterinere, mjedisore dhe fushave tjera relevante.

Hapi 3 dhe 4

1.2 Formimi i ekipit për vlerësim të përbashkët të riskut dhe përfshirja e akterëve tjerë

Pas konfirmimit se një ngjarje e raportuar e cila mund të konsiderohet rrezik i menjëhershëm për shëndetin publik, në varësi të cilësisë dhe plotënisë së informacionit të disponueshëm për të vlerësuar riskun, duhet të formohet ekipi për vlerësimin e përbashkët të riskut. Sipas Ligjit për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse nr.08/L-200, Neni 22 Paralajmërimi i hershëm i ngjarjes sinjalizimi dhe vlerësimi i rrezikut paragrafi 3. IKShPK bënë vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut dhe sipas nevojës në koordinim me njësitë tjera përkatëse. Pra, varësisht nga lloji i riskut, që mund të jetë nga pjesa humane, animale ose e mjedisit, Institucionet përgjegjëse propozojnë themelimin e ekipit për vlerësim të riskut me vendim të drejtuesit/es të institucionit/agjencisë/departamentit.

Vendosja për sektoret që duhet të përbëjnë ekipin e vlerësimit të përbashkët të riskut është një hap kritik që shpesh anashkalohet. Ekspertiza shtesë (p.sh. në shëndetin e kafshëve, sigurinë ushqimore, ambientin ose mbrojtjen nga rrezatimi, toksikologji) mund të përfshihet në çdo kohë, por mund të jetë e nevojshme në fillim të vlerësimit të riskut nëse:

- rreziku është i panjohur,
- ngjarja e pazakontë që shkaktohet nga një agjent infektiv,
- ngjarja lidhet me sëmundje ose vdekje të kafshëve, dhe/ose identifikohet si zoonozë e dyshuar
- ngjarja lidhet me tërheqje të ushqimit ose produktit, aksident të njohur kimik, ose incident radionuklear me ose pa raporte të sëmundjes tek njerëzit.

Komunikimi në mes institucioneve përgjegjëse dhe komunikimi i riskut janë pjesë integrale e menaxhimit të riskut. Sigurimi i komunikimit të mirë midis vendimmarrësve dhe popullsisë së prekur që nga fillimi i procesit do të rrisë gjasat e zbatimit efektiv të masave të kontrollit, veçanërisht ato që kërkojnë ndryshim të sjelljes. Njohuritë dhe ekspertiza e ekipit ndikojnë shumë në vlerësimin e riskut. Njohuritë lokale për mjedisin në të cilin ndodh ngjarja janë komponent kritik i vlerësimit të riskut. Niveli i rrezikut të një ngjarjeje akute të shëndetit publik varet nga kushtet sociale, ekonomike, mjedisore dhe politike në zonën e prekur dhe efektiviteti i shërbimeve shëndetësore lokale (p.sh. shërbimet e trajtimit dhe shëndetit publik).

2. Moduli 2 “Korniza e riskut”

Hapi 5

Korniza e riskut e koordinuar nga kryesuesi i ekipit të vlerësimit të përbashkët të riskut përcakton rrezikun si dhe fushën, qëllimin dhe objektivat kryesore të vlerësimit të riskut, sipas modelit në Aneksin A. Përmes kësaj kornize, adresohen shqetësimet kryesore që lidhen me ngjarjen ose kërcënimin, për të siguruar rezultate praktike dhe të dobishme për të mbështetur vendimmarrjen, zbatimin dhe komunikimin e riskut në menaxhimin e ngjarjes ose kërcënimit. Secili sektor kryen një vlerësim të riskut specifik për sektorin për ngjarjen, dhe sjell informacionin dhe rezultatet e tyre në vlerësimin e përbashkët por kjo është e mundur edhe nëse vlerësimet specifike për sektorin nuk janë përfunduar.

2.1 Definimi i rrezikut specifik

Edhe pse, rreziku mund të jetë i njohur para fillimit të procesit të vlerësimit të përbashkët të riskut, konfirmimi i riskut specifik siguron një diskutim të fokusuar. Sa më i përafërt të jetë risku, vlerësimi dhe rezultatet do të jenë më të dobishme. Shembuj të rreziqeve:

- virusi i gripit avian A(H7N9)
- viruset e gripit avian
- viruset e gripit potencialisht zoonotik

2.2 Përcaktimi i fushëveprimit

Fushëveprimi i vlerësimit të përbashkët të riskut, në shumicën e rasteve do të jetë vlerësim i rreziqeve shëndetësore në ndërveprimin njeri–kafshë–mjedis i shkaktuar nga rreziku i dakorduar në nivel vendi, në një zonë gjeografike specifike (komunë, lokalitet).

Ekipi i vlerësimit të përbashkët të riskut përmbledh dhe diskuton çështjet specifike të sektorëve përkatës (pyetjet e vlerësimit të riskut dhe rrugët e riskut). Për vlerësim të përbashkët të riskut ekipi mund të shfrytëzojë rezultatet e vlerësimeve specifike të sektorëve.

- Shembull fushëveprimi:

Rreziqet shëndetësore në ndërveprimin njeri–kafshë–mjedis që shkaktohen nga virusi i gripit të shpendëve H7N9 i cili aktualisht po qarkullon në vendin fqinj X.

2.3 Pajtuëshmëria për qëllimin dhe objektivat kryesore

Në përgjithësi, qëllimi i çdo vlerësimi të përbashkët të riskut është zbutja e rreziqeve, ndërsa objektivi kryesor është të ofrojë rekomandime për masa parandaluese dhe të kontrollit dhe komunikimit me kohë. Këto diskutohen, dakordohen dhe komunikohen me Ekipin e vlerësimit të përbashkët të riskut .

Shembull:

Në Kosovë, rreziku kryesor është nga ethet hemorragjike Krime Kongo, e cila paraqet shqetësim të vazhdueshëm për shëndetin publik, veçanërisht në zonat endemike. Shqetësimi kryesor i ekipit për vlerësim të përbashkët të riskut është shkalla e lartë e vdekshmërisë nga ethet hemorragjike Krime Kongo. Ekipi për vlerësim të përbashkët të riskut është i shqetësuar për rreziqet në ndërveprimin kafshë–njeri–mjedis, veçanërisht midis banorëve të zonave endemike si pasojë e ekspozimit ndaj rriqrave që janë bartës të virusit të etheve hemorragjike Gjithashtu ekziston shqetësim për rrezikun e

përhapjes së virusit gjatë trajtimit klinik të rasteve dhe kontaktit me gjak ose inde të infektuara, që mund të çojë në infektimin e stafit shëndetësor dhe personave të tjerë që punojnë në fusha dhe i ekspozohen pickimit të rriqërave. Çështja është me interes kombëtar, kur periudhat me aktivitetet të shtuar të rriqërave rrisin mundësinë e ekspozimit ndaj rriqërave dhe përhapjes së sëmundjes. Vlerësimi i përbashkët i riskut duhet të ofrojë rekomandime për zbutjen e rrezikut dhe të marrë parasysh përmirësimin e sigurisë për popullatën e këtyre zonave dhe punëtorët shëndetësor. Si rrjedhojë, të gjitha institucionet që janë të përfshira në shëndetin e njerëzve, shëndetin e kafshëve dhe mbikëqyrjen e mjedisit duhet të kenë përfaqësues në ekipin për vlerësim të përbashkët të riskut, së bashku me ekspertët të cilët zhvillojnë studime dhe mbikëqyrje epidemiologjike për ethet hemorragjike në vend.

3. Moduli 3 “Zbatimi”

Hapi 6

3.1 Identifikimi dhe skicimi i rrugës së riskut

Duke marrë parasysh riskun, shkallën, qëllimin dhe objektivat kryesore të përcaktuara në kornizën e rrezeve ekipi për vlerësim të përbashkët të riskut, identifikon të gjitha rrugët e mundshme të riskut, pavarësisht nga probabiliteti i tyre.

Rruga e riskut përshkruan sekuencën logjike të lëvizjes së riskut nga burimi i tij deri në infektimin e njeriut/kafshës. E gjithë rruga e riskut për shumicën e zoonozave shtrihet që nga momenti kur patogjeni hyn në vend/shtet, përmes përhapjes së tij tek kafshët dhe tek njerëzit (ose nikoqirë të tjerë), dhe potencialisht përsëri tek kafshët. Identifikimi i pikave dhe proceseve në rrugën e riskut nga çdo burim i rrezikut.

Ekipi për vlerësim të përbashkët të riskut, identifikon të gjitha rrugët e mundshme të lëvizjes së rrezikut. Duke ndjekur të gjitha pikat e mundshme nga burimi deri te ekspozimi i nikoqirit njeri (ose e kundërta nga kafsha te njeriu), shpjegon të gjitha proceset përgjatë rrugës. Gjithashtu këtu përfshihen transporti i kafshëve, ekspozimet/infektimet e mundshme në speciet tjera dhe në kafshët e egra, si dhe pikat kufitare të përshkuara.

Burimi i patogjenit mund të jetë i njohur ose i panjohur. Nëse burimet janë të panjohura, propozohen të gjitha burimet e mundshme. Shembuj të burimeve të rëndësishme për gripin e shpendëve janë: pulëbardhat e shtëpisë, zogjtë e egër, tregjet me kafshë të gjalla, njësitë tregtare të pulave, produktet e pulave dhe pajisjet përcjellëse. Duhet të përfshihet çdo rrugë rreziku e supozuar e cila nuk dihet në detaje, duke identifikuar dhe shënuar boshllëqet e informacionit. Analiza e zinxhirit identifikon pika dhe procese të rëndësishme në rrugën e riskut të lidhura me shëndetin e kafshëve. Rrugë të tjera të mundshme të riskut duhet të konsiderohen, si ekspozimi i pulës së shtëpisë përmes zogjve të egër ose kafshëve shtëpiake. Pasi rruga e riskut të jetë identifikuar dhe të jenë dakordësuar, dokumentohen në raportin e vlerësimit të përbashkët të riskut.

Hapi 7

3.2 Formulimi dhe dokumentimi i pyetjeve për vlerësim të riskut

Nisur nga rezultatet e kornizës së riskut dhe rrugës së riskut, ekipi për vlerësim të përbashkët të riskut harton pyetje të sakta për vlerësimin e riskut me qëllim të sigurimit se vlerësimi i riskut është praktik dhe i rëndësishëm me qëllim të marrjes së masave adekuate për parandalim dhe kontrollë.

Shtojca jep shembuj për të treguar se si korniza e riskut dhe pyetjet e vlerësimit të riskut kontribuojnë në menaxhim të riskut. Sipas kornizës së riskut (Moduli 2: hapi 5), ekipi për vlerësim të përbashkët të riskut fokusohet në rrugët e riskut në ndërveprimin njeri–kafshë–mjedis.

Bazuar në diskutimin teknik, pyetjet shitesë mund të shfaqen më vonë apo edhe pyetjet specifike për riskun i cili do të vlerësohet. Ekipi për vlerësim të përbashkët të riskut diskuton dhe arrin marrëveshje mbi pyetjet të cilat do të adresohen.

3.2.1 Formulimi i pyetjeve për vlerësimin e përbashkët të riskut

Hartohen duke përdorur formatin e përgjithshëm “Sa është probabiliteti/mundësia/gjasa dhe ndikimi/impakti i...?”;

Pyetjet janë specifike, duke shënuar në çdo pyetje të vlerësimit të riskut: Rrezikun/hazardin (p.sh. “virusi i gripit të shpezëve H7N9”);

Ngjarjen/objekti që do të vlerësohet (p.sh. “të paktën një person sëmuret klinikisht”, “sëmundja zbulohet në një vend tjetër”, “virusi fillon të qarkullojë lokalisht”);

Vendndodhja gjeografike (p.sh. “brenda komunës/lokalitetit A”, “në tregjet e kafshëve të gjalla”, “në zonat që tashmë janë prekur”, “në zonat e paprekura që kufizojnë zonat e prekura”);

- Popullata (p.sh. “në punonjësit e tregut të kafshëve të gjalla”, “në punonjësit e kujdesit shëndetësor”, “te fëmijët”, “në punonjësit e fermave të pulave”);
- Burimi (p.sh. “për shkak të virusit që vjen nga zogjtë e egër”, “për shkak të virusit në mishin e pulës të papërpunuar/përpunuar”)
- janë të rëndësishme nëse ato:
 - përshtaten me fushën e dakorduar dhe bazohen në objektivat e VPR-së
 - janë të dakordësuar nga të gjithë ekipi i VPR-së;
 - kanë kohë të kufizuar, dmth. jepet një periudhë kohore (p.sh. “në 12 muajt e ardhshëm”, “gjatë këtij shpërthimi”);
 - përshkruajnë rezultatin e padëshiruar (p.sh. përhapjen e sëmundjes, rritjen e numrit të rasteve/vdekjeve)

Figura 2. Formulimi i pyetjeve specifike, relevante dhe me kohë për vlerësimin e përbashkët të riskut

CILI	është probabiliteti dhe ndikimi i...
ÇFARË	rreziku dhe ngjarje (siç është dakorduar gjatë kornizës së riskut)
KU	popullata dhe vendndodhja gjeografike
KUR	periudha kohore
SI	burimi (mund të përpunohet/përcaktohet/finalizohet më vonë, pas diskutimit të rrugëve të riskut)

Shembull

Cili është probabiliteti/mundësia dhe ndikimi që të paktën një konsumator në vend të ekspozohet ndaj virusit të gripit A(H7N9) në një treg të gjallë shpezësh gjatë 6 muajve të ardhshëm?

Duke përdorur kriteret e mësipërme, një pyetje e vlerësimit të riskut është: “Cili është probabiliteti dhe ndikimi i ekspozimit të së paku një punonjësi të fermës së pulave nga komuna/lokaliteti A ndaj virusit infektiv të gripit të shpezëve H7N9 brenda 12 muajve të ardhshëm?” Mund të shtohen kriterë shtesë, për shembull, “... si rezultat i pranisë së këtij virusi në popullsinë lokale të zogjve të egër?”

Tabela 1 harton pyetjet për vlerësimin e riskut. Pyetja gjithmonë fillon me “Cili është probabiliteti dhe ndikimi i...” dhe pastaj vazhdon duke përdorur pyetjet shtesë.

Tabela 1. Pyetjet për vlerësimin e përbashkët të riskut

	Numri/ shkalla	Popullësia e synuar	Vendndodhja gjeografike	Rezultatet	Hazardi/rrezi ku	Burimi i ekspozimit	Korniza kohore
Cili është probabiliteti dhe ndikimi i...	Së paku një	Punëtor në shpeztari	Në një treg kafshësh të gjalla	Të ekspozuar	H5N1 Avian Influenca virus	(NA, ndonjë burim)	Gjatë sezonës së ardhshme të gripit, me aktivitet të lartë
	Rritje e numrit	Fëmijë	Në vend	Të vdekur	H5N1 Avian virus	(NA, ndonjë burim)	Gjatë shpërthimit të H5N1
	Së paku një	Konsumator/ blerës	Në komunën/lokalitetin A	Prezanton me pasqyrë klinike të sëmundjes	Nëntipi i ri i virusit të gripit të kafshëve	Në tregun e shpezëve të gjalla X	Në 12 muajt e ardhshëm
	(NA, ndonjë)	Tregjet e shpezëve të gjallë	Në kufi me komunën A	Përhapje	H7N9 Avian Influenca virus	(NA, ndonjë burim)	Gjatë sezonit të vitit të ardhshëm
	Së paku një	Raste humane	Në komunën X	Të ekspozuar	Virusi Ebola	Kafshë të egra	Periudhë specifike e migrimit të lakuriqëve të natës/periudha e frytëzimit të pemëve
	Së paku një	Turist	Parku nacional	Të infektuar	Virusi i ethes hemorrhagjike EHKK dhe EHSV	Rriqërat Ixode, minjtë	Periudha e ecjeve të grupeve të organizuara në natyrë
	Rritje e numrit	Punëtorët në therrtore	Në vendin Y	Të infektuar	Brucelloza	Kafshët e infektuara dhe produktet e qumështit	Festat kryesore

3.2.2 Kontrolloni pyetjet e vlerësimit të riskut

Gjatë takimit të ekipit të VPR-së, mund të lindin pyetje që janë të rëndësishme për t'u përgjigjur ose për t'u diskutuar, por që nuk janë pyetje të vlerësimit të riskut. Këto shpesh janë pyetje nga hulumtimi epidemiologjik ose nga vlerësimi i situatës. Edhe pse procesi standard i vlerësimit të përbashkët të riskut nuk zbatohet për këto pyetje, ato mund të jenë shumë të rëndësishme si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të situatës dhe për të plotësuar boshllëqet e të dhënave, dhe duhet të diskutohen nëse kanë kuptim për ekipin.

Këshillë

Një pyetje NUK MUND TË JETË një pyetje e vlerësimit të përbashkët të riskut nëse:

- nuk fillon me "Cili është probabiliteti dhe ndikimi i...";
- ekziston përgjigja dhe mund të përcaktohet duke mbledhur më shumë ose më mirë të dhënat;
- i referohet diçkaje që po ndodh tani dhe jo diçkaje që mund të ndodhë në të ardhmen;
- nuk lidhet drejtpërdrejt me vendimin se si të menaxhohet një risk.

Shembuj pyetjesh që **nuk janë pyetje** të vlerësimit të përbashkët të riskut:

- 3.2.2.1 Cili është probabiliteti që virusi H7N9 të qarkullojë në tregun e shpezëve të gjalla X këtë vit?
- 3.2.2.2 Cila është shkalla e përhapjes së virusit H5N1 te shpezët në vendin X këtë muaj?
- 3.2.2.3 Cili është probabiliteti që virusi H5N1 të kalojë kufirin nga vendi X gjatë këtij shpërthimi?
- 3.2.2.4 Cili është rreziku që shoqërohet me importimin e shpezëve nga vendi Y gjatë këtij shpërthimi?

Ndonjëherë këto mund të shndërrohen në pyetje vlerësimi të riskut, p.sh. **Cili është probabiliteti dhe ndikimi** i një dërgese të kundërligjshme të shpezëve të infektuara me virusin H5N1 që kalon kufirin nga vendi X?

3.2.3 Dokumentoni pyetjet e vlerësimit të përbashkët të riskut

Regjistroni pyetjet e formuluar të vlerësimit të përbashkët të riskut sipas Aneksit

Shembull: Pyetje mbi rrezikun për Brucellozën

"Cili është probabiliteti dhe ndikimi që të paktën një punëtor në një fermë në komunën/lokalitetin X të infektohet me Brucella përmes kontaktit me mishin dhe lëngjet nga një kafshë e infektuar gjatë periudhës janar-dhjetor?"

Hapi 8

Karakterizimi i riskut

Bazuar në pyetjet e vlerësimit të përbashkët të riskut dhe rrugët e riskut, pra duke konsideruar rrezikun/hazardin, shkallën, qëllimin dhe objektivat kryesore të identifikuar realizohet vlerësimi teknik nga ekipi për vlerësim të përbashkët të riskut sipas Aneksit B

Nëse propozohen ose identifikohen më shumë pyetje se sa mund të vlerësohen, bëhet prioritizimi dhe zgjedhja e pyetjeve bazuar në:

- shqetësimet kryesore të përshkruara në kornizën e riskut;
- pyetjet që lidhen ngushtë me vendimet praktike të menaxhimit;
- pyetjet kryesore për komunikimin me publikun.

Hapi 8.1. Shqyrtimi i informacionit në dispozicion

Ekipi i VPR -së, duhet të grumbullojë të dhënat nga literatura në dispozicion, raportet teknike, të dhënat e mbikëqyrjes epidemiologjike, siç përshkruhet në Shtojcën G, të shkëmbehen mes sektorëve dhe të identifikohen mungesa e të dhënave që kanë ndikim në vlerësim.

Këto informata mund të jenë, si:

- informatat e siguruar për vlerësim të riskut, të ndara paraprakisht, ose çdo informatë shtesë,
- rezultatet e vlerësimeve të riskut specifike për sektorët,
- opinioninin e ekspertëve të jashtëm që mund të ftohen nga ekipi i VPR-së.

Njohuritë e ekspertëve vendor të fushës përkatëse janë veçanërisht të dobishme kur nuk ka informata të mjaftueshme. Për shembull, ekspertët nga universiteti mund të përkrahin rishikimet e literaturës dhe të gjitha informatat e grumbulluara duhet të jenë të dokumentuara.

Pa marrë parasysh cilësinë ose sasinë e të dhënave, ekipi duhet të bëjë VPR-në. Pra me ato të dhëna në dispozicion, ekipi:

- bazohet më shumë në opinionin e ekspertëve,
- bën supozime të arsyeshme,
- shfrytëzon informacionet e ngjarjeve të ngjashme në rrethana të ngjashme në vend;
- shfrytëzon informacionet nga zonat/vendet e tjera ose nga patogjenë të ngjashëm (p.sh. publikime, përvoja).

Dhe pastaj:

- identifikon këta faktorë si boshllëqe të të dhënave,
- reflekton këto boshllëqe në nivelin e pasigurisë që i është caktuar.

Kur ekspertiza për rrezikun/hazardin e caktuar është e kufizuar (p.sh. sëmundja kurrë nuk ka ndodhur në vend), kërkohet ekspertizë shtesë (p.sh. ekspertë rajonalë ose ndërkombëtarë).

Përkundër mungesës së të dhënave të mjaftueshme, ekipi mund të bëjë disa supozime për shembull, mbi praktikën dhe përvojat paraprake ose të dhënat epidemiologjike për sëmundjen. Këto supozime mundësojnë që të kryhet një vlerësim i riskut në kontekste të njohura, por të paprovuara më herët.

Për shembull, ekipi supozon:

- rastet/vdekjet të njerëzve kanë lidhshmëri epidemiologjike me ekspozimin ndaj kafshëve të infektuara, megjithëse nuk ka prova në terren;
- higjiena, praktikën dhe therrja në tregjet e kafshëve të gjalla në komunën/lokalitetin A janë të ngjashme me ato të B;
- të dhënat nga mbikëqyrja epidemiologjike mund të identifikojnë rastet në vend;

Të gjitha këto supozime mund të ndihmojnë në vlerësimin e probabilitetit dhe ndikimit të riskut.

Hapi 8.2. Identifikimi i boshllëqeve të informacionit (Aneksi A)

Në këtë hap, ekipi identifikon dhe dokumenton informacionin që mungon ose që është me cilësi të pamjaftueshme dhe e paraqet në raportin e VPR-së. Kjo mund të bëhet paralelisht me hapin 8.1 ku identifikohen mungesa e informacioneve. (Shqyrtimi i informacionit në dispozicion).

Pas bërjes së vlerësimeve në hapin 8.3, jepni prioritet boshllëqeve në të dhënat e shënuara në hapin 8.2.

Në raport paraqiten diskutimet dhe propozimet për hapat e ardhshëm dhe afatet kohore për sigurimin e informacionit, caktimin e anëtarit përgjegjës në ekip dhe burimet e mundshme të informacionit. Nëse informacioni është me rëndësi për menaxhimin e riskut, disponueshmëria e tij e mund të shfrytëzohet në rast nevojë për vlerësimin e ardhshëm.

Hapi 8.3. Vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit si dhe përcaktimi i pasigurisë për secilën pyetje të vlerësimit të riskut (Aneksi A)

Në këtë hap, ekipi i VPR-së trajton secilën pyetje të vlerësimit të riskut individualisht, duke marrë parasysh rrugët përkatëse të rrezikut dhe faktorët përkatës të rrezikut për secilën.

Në mungesë të të dhënave apo informacioneve jo cilësore:

- PËRPIQUNI të bëni vlerësime të sakta të probabilitetit dhe ndikimit, e pastaj caktoni pasigurinë e lartë.
- Mos bëni vlerësime të probabilitetit dhe ndikimit si “të moderuara” si balancë në mungesë të dëshmive.

8.3.1. Vlerësimi i probabilitetit

Për çdo pyetje të vlerësimit të riskut, probabiliteti (shansi që situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të riskut të ndodhë) vlerësohet bazuar në (1) informacionin e disponueshëm, dhe (2) opinionin e ekspertëve të ekipit të VPR-së.

Ekipi merr parasysh kontekstin ku po ndodh ngjarja, për kapacitetet e nivelit lokal, i cili mund të ndikojë në probabilitetin ose ndikimin e kësaj ngjarje. Ky vlerësim mund të përfshijë faktorë që janë infrastrukturë/programatik, social, etik, teknik, shkencor, ekonomik ose mjedisor/ekologjik, evoluimi i patogjenëve, kapaciteti për zbulimin e rasteve, ashpërsia e sëmundjes tek njerëzit, dhe kapaciteti i sistemit shëndetësor për të reaguar në mënyrë efektive.

Nëse ekipi nuk është në gjendje të caktojë një vlerësim të probabilitetit për një pyetje specifike të vlerësimit të riskut sipas të dhënave në dispozicion, ekipi shënon dhe regjistron boshllëqet e të dhënave për atë pyetje dhe shpjegon vendimin në raport. Ekipi vazhdon të kryej të gjithë hapat e tjerë të vlerësimit për të gjitha pyetjet e vlerësimit të riskut.

Vlerësimet e probabilitetit bëhen caktohen sipas kategorisë cilësore, si në Tabelën 2, bazuar në vlerësimin e probabilitetit që situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit mund të ndodhë.

Tabela 2. Kriteret për vlerësim të probabilitetit

Vlerësimi i probabilitetit	Kriteret
I lartë	Situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të riskut ka gjasa të ndodhë
Mesatar	Situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të riskut mund të ndodhë
I ulët	Situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të rrezikut nuk ka gjasa të ndodhë
I parëndësishëm	Situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të riskut është pothuajse e sigurt që nuk do të ndodhë, por mund të ndodhë në rrethana të jashtëzakonshme

Arsyetimi për çdo vlerësim duhet të shenohet: përfshirë të gjitha informacionet kryesore mbi të cilat është bazuar vlerësimi, në mënyrë që të tjerët të mund të kuptojnë vendimin e ekipit gjatë vlerësimit.

8.3.2. Caktimi i pasigurisë për probabilitetin

Për çdo pyetje të vlerësimit të riskut, niveli i pasigurisë (sa e mundshme është që vlerësimi i riskut për probabilitetin ose ndikimin të jetë i vërtetë) caktohet bazuar në: (1) cilësinë dhe sasinë e të dhënave të disponueshme, dhe (2) opinionin e ekipit VPR-së. Hapi 8.1 përshkruan për të dhënat në dispozicion. Edhe kur ka informacion minimal ose cilësi të dobët, probabiliteti dhe ndikimi vazhdojnë të vlerësohen para se të caktohet një nivel i lartë pasigurie.

Niveli i pasigurisë caktohet sipas kriterëve në Tabelën 3.

Tabela 3. Kriteret për vlerësimin e nivelit të pasigurisë

Pasiguria	Kriteret
Shumë i lartë	Mungesë e të dhënave ose informacioni të besueshëm; rezultatet bazohen vetëm në spekulime
I lartë	Të dhëna të kufizuara ose informacion i besueshëm në dispozicion; rezultatet bazohen në supozime
Mesatar	Boshllëqe në disponueshmërinë ose besueshmërinë e të dhënave dhe informacionit, ose të dhëna kontradiktore; rezultate bazuar në konsensus të kufizuar
I ulët	Të dhëna dhe informacione të besueshme të disponueshme, por mund të jenë të kufizuara në sasi, ose të dhëna të ndryshueshme; rezultatet bazohen në konsensusin e ekspertëve
Shumë i ulët	Të dhëna dhe informacione të besueshme janë të disponueshme në sasi të mjaftueshme; rezultatet janë të bazuara në të dhëna empirike ose informacione konkrete

8.3.3. Vlerësimi i ndikimit/ impaktit

Çdo pyetje vlerëson ndikimin: se si ajo situatë e përkeqësuar do të ndodhte saktë ashtu siç është e përshkruar në pyetje.

Ekipi zakonisht vlerëson ndikimin në popullatë, në nivel lokal, kombëtar ose ndërkombëtar e jo në nivel të individit. Ndikimi në nivelin e individual zakonisht lidhet me ashpërsinë e sëmundjes dhe është një faktor në vlerësimin e kontekstit.

VPR-ja mund të marrë parasysh vetëm ndikimet direkte në shëndet dhe sistemet e shëndetësisë ose mund të përfshijë një grup më të gjerë ndikimesh direkte dhe indirekte, p.sh. ekonomike, sociale, mjedisore.

Vlerësimet e ndikimit caktohen në një rën nga katër kategoritë cilësore, siç tregohet në Tabelën 4, bazuar në vlerësimin e ndikimit nëse situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të riskut do të ndodhte.

Tabela 4. Kriteret për të vlerësuar ndikimin nëse ndodh situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të riskut

Vlerësimi i ndikimit	Kriteret	Shembuj me ndikim direkt	Shembuj me ndikim indirekt (ekonomik, social, mjedisor)
I lartë I RËNDË	Situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të riskut do të ketë pasoja të mëdha NEGATIVE për shëndetin e (ose sistemin shëndetësor) të popullatës.	- Pandemi potenciale në popullatë (ose grupet e mëdha të rrezikuara) ose të kafshët (shtëpiake dhe të egra) me vdekshmëri të lartë; humbje të konsiderueshme në prodhimin e bagëtive në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar - Çrregullim i rëndë i aktiviteteve dhe shërbimeve normale	- Kërcënim për tregtinë kombëtare dhe ndërkombëtare: humbje të pjesës së tregut, ndalime të importit në vende të tjera, ulje të çmimeve të produkteve (mish, vezë) - Numër i madh masash të nevojshme në nivelet kombëtare dhe ndërkombëtare me kosto të konsiderueshme për autoritetet dhe palët e interesit - Kërcënim për sigurinë ushqimore dhe/ose furnizimet ushqimore dhe në mënyrë indirekte jetën e njerëzve në nivel kombëtar - Nivel i ngjashëm i ndërprerjeve në sektorë të tjerë
Mesatar MESATAR	Situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të riskut do të ketë pasoja të rëndësishme NEGATIVE në shëndetin (ose sistemin shëndetësor) të popullatës.	Raportime të rasteve në disa rajone me vdekshmëri të konsiderueshme në popullatë (ose grupet me rrezik të mesëm) ose kafshët (shtëpiake dhe të egra)	- Mund të jetë një kërcënim për sigurinë ushqimore ose furnizimin me ushqim dhe në mënyrë indirekte jetën e njerëzve në nivel rajonal - Kërcënim kryesisht për tregtinë kombëtare, por ndoshta edhe për tregtinë ndërkombëtare të produkteve specifike të prodhuara në rajonet e prekura (p.sh. gripi i shpejtëve) - Disa masa të nevojshme në nivel rajonal dhe kombëtar që përfshijnë kosto të mëdha - Nivel i ngjashëm ndërprerjesh në sektorë të tjerë
I ulët I VOGËL	Situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të riskut do të ketë pasoja minimale NEGATIVE në shëndetin (ose sistemin shëndetësor) të popullsisë.	- Numër i vogël i rasteve të raportuara (kryesisht në grupe të vogla në rrezik) me vdekshmëri të rrallë dhe numër të ulët të rasteve në kafshë (shtëpiake ose të egra), me vdekshmëri të ulët - Zona të vogla të prekura (nivel rajonal ose lokal)	- Asnjë kërcënim për sigurinë ushqimore ose ekonominë - Masat e nevojshme në nivel rajonal me kosto të ulët deri në të moderuar - Nivel i ngjashëm ndërprerjesh në sektorë të tjerë
I parëndësishëm	Situata e përshkruar në pyetjen e vlerësimit të riskut do të ketë pasoja NEGATIVE të parëndësishme në shëndetin (ose sistemin shëndetësor) të popullsisë.	Nuk ka raportime të rasteve humane dhe të kafshëve (shtëpiake ose të egra) ose ka një numër të ulët të raportimeve të rasteve të lokalizuara në kafshë.	- Asnjë kërcënim për sigurinë ushqimore ose ekonominë - Pak masa të nevojshme në nivel nën-rajonal ose më të ulët; kosto të vogla të masave të zbatuara në nivel nën-rajonal - Nivel i ngjashëm ndërprerjesh në sektorë të tjerë

Nëse ekipi gjatë vlerësimit të përbashkët të riskut ka vështirësi në marrjen e një vendimi si pasojë e mendimeve të ndryshme të ekspertëve, ata duhet të arrijnë konsensus për një vlerësim të vetëm i bazuar në provat dhe dëshmitë në dispozicion.

8.3.4. Caktoni pasigurinë për ndikimin/impaktin

Pasi të përfundohet vlerësimi i probabilitetit, vlerësohet niveli i pasigurisë për ndikimin apo impaktin, referuar Tabelës 3 në hapin 8.3.2.

Është thelbësore t'u përcillet vendimmarrësve niveli i pasigurisë dhe dokumentim i qartë i procesit në raportin e VPR-së. Në bazë të informacionit specifik, vendimmarrësit do të përcjellin mesazhet për atë që është e panjohur, pse dhe hapat e nevojshëm për mbledhjen e informacionit të nevojshëm.

8.4. Vlerësimi sipas matricës (Aneksi A)

Vlerësimi i probabilitetit/gjasës dhe ndikimit/impaktit paraqitet sipas matricës së rrezikut (Fig. 3) ku për çdo pyetje të vlerësimit të riskut mundëson lidhshmërinë në mes të rrezikut me opsionet e mundshme për menaxhimin e riskut. Një shenjëzim në matricë tregon risk të vlerësuar për secilën pyetje të vlerësimit të riskut. Vlerësimet individuale për secilën pyetje nuk kombinohen, por interpretohen veçmas.

Niveli i pasigurisë i lidhur me secilën pyetje të vlerësimit të riskut përfshihet kur raportohen ose diskutohen vlerësimet e probabilitetit/gjasave dhe ndikimit.

Figura 3. Matrica e rrezikut

Probabiliteti	I lartë				
	Mesatar				
	I ulët				
	I parëndësishëm				
		I parëndësishëm	I vogël	Mesatar	I rëndë
		Ndikimi/impakti			

Për shembull, rezultatet e vlerësimit të riskut (probabiliteti/gjasa dhe ndikimi i paraqitjes së një sëmundjeje në bagëti) mund të lidhet me menaxhimin e riskut (të dhënat nga mbikëqyrja), si më poshtë:

- **e kuqe:** kritike për zbatimin e masave për parandalim dhe kontrollë (mbikëqyrje e zgjeruar);
- **e verdhë:** rishikimi dhe përshtatja e masave për parandalim dhe kontrollë (fuqizim i mbikëqyrjes: e targetuar ose e lidhur me aktivitetet ekzistuese të mbikëqyrjes);
- **e gjelbër:** mbajtja e masave aktuale për parandalim dhe kontrollë (mbikëqyrje e vazhdueshme)

Interpretimi teknik

Bazuar në vlerësimet e probabilitetit dhe ndikimit, duke marrë parasysh nivelin e pasigurisë për secilën prej pyetjeve të vlerësimit të riskut, dhe duke pasur parasysh situatën dhe kontekstin, ekipi i VPR-së ofron interpretim teknik cilësor të vlerësimit të përgjithshëm të riskut për vendimmarrësit. Interpretimi

teknik për secilën pyetje të vlerësimit të riskut është bazë për vendimet për menaxhimin e riskut. Raporti teknik duhet të përfshijë një përmbledhje të shkurtërtë:

- pyetjeve të vlerësimit të riskut;
- supozimeve kryesore;
- vlerësimit të probabilitetit dhe ndikimit si dhe pasigurive;
- arsyetimit për vlerësim;
- opsioneve kryesore për menaxhim dhe komunikim të riskut.

Më poshtë është një interpretim teknik i shkurtuar i paraqitur nga një ekip i VPR-së

"Ekipi vlerësoi mundësinë dhe ndikimin për të paktën një personi në Rajonin e Liqenit X që të ekspozohet ndaj virusit H5N1 HPAI nga rosat e infektuara të oborrit në tre muajt e ardhshëm, dhe arriti në përfundimin se gjasat dhe ndikimi janë mesatare. Ky përfundim supozoi se ekziston mundësia e importimit të shpendëve të infektuar nga vendet fqinje të prekura sepse nuk ka inspektim në pikat kufitare.

Vlerësimi mesatar i probabilitetit bazohet në të dhënat e disponueshme për zogjtë që migrojnë nga vendet e prekura, si dhe në hulumtime të shumta të botuara në vendet tjera, të cilat zbuluan se tregjet e shpezëve të gjallë, të ngjashme me ato nëvend, janë me rrezik të lartë për përhapjen e sëmundjes.

Vlerësimi mesatar i ndikimit për shfaqjen e virusit H5N1 HPAI bazohet në vlerësimin e humbjeve ekonomike për shkak të humbjes së stokut të shpezëve dhe besimit të konsumatorit, mungesës së vaksinave, shkallës së lartë të vdekshmërisë të njerëzve dhe konsumimit të mishit të shpezëve si ushqim dhe e paraqitur në raport mungesën e përhapjes së infeksionit njeri-njeri, informatë kjo nga hulumtimet në vendet tjera.

Ekspertët menduan se pika e fundit uli ndikimin krahasuar me ngjarje të ngjashme të sëmundjeve.

Pasiguria për të dy vlerësimet është e ulët për shkak të disponueshmërisë së informacionit të besueshëm. Edhe pse vetëm një sasi e kufizuar informacioni vjen nga brenda vendit, ka hulumtime mbi sëmundjen në disa vende fqinje.

Ekipi i VPR-së rekomandoi për masa zbutëse dhe komunikim. Për shembull: fuqizimi i ligjeve dhe rregulloreve në lidhje me masat e kontrollit për importin e shpezëve, si karantina veterinare në të gjitha pikat kryesore kufitare dhe inspektimi i certifikatave; vendosja e materialeve informuese në pozicione të dukshme në pikat kufitare, komunikimi i drejtpërdrejtë i rregulloreve të reja autoriteteve dhe individëve/kompanive private në vendet eksportuese.

Ky vlerësim është i bazuar në të dhënat dhe informacionin e marrë nga opinionet e ekspertëve, literatura dhe organizatat zyrtare për standarde ose organizatat teknike, duke përfshirë OIE-në, OBSH-në dhe FAO-n. Ekziston një boshllëk i konsiderueshëm informacioni në lidhje me mbikëqyrjen brenda vendit për HPAI-në. U rekomandua që mbikëqyrja aktive të kryhet brenda vitit të ardhshëm dhe një VPR e rradhës të kryhet me informacionin e përditësuar.

4. Moduli 4 “Përdorimi i rezultateve”

Hapi 9

Identifikimi i opsioneve për menaxhim dhe komunikim të riskut

Qëllimi i vlerësimit të riskut është të ofrojë opsionet e menaxhimit dhe komunikimit të riskut brenda fushëveprimit, qëllimit dhe objektivave të përcaktuara nga ekipi për vlerësim të përbashkët të riskut. Ekipi priorizon opsionet dhe diskuton e dokumenton opinionet për dhe kundër të justifikuara teknikisht, përfshirë kost-benefitin e secilit opsion, të justifikuara shkencërisht. Për shembull, ato masa të menaxhimit të riskut me ndikimin më të lartë në uljen e riskut të përgjithshëm dhe ndikimin më të ulët negativ në prodhim, mirëqenien e kafshëve, të quajtura edhe pika kritike të kontrollit, mund të merren në konsideratë kur priorizohen opsionet.

Faktorët dhe variablat që kontribuojnë në risk, siç diskutohen gjatë karakterizimit të riskut dhe përfshihen në arsyetim (moduli 3: hapi 8) duhet të jenë baza për zhvillimin e opsioneve të menaxhimit dhe komunikimit të riskut. Ekipi i VPR-së propozon opsione të përgjithshme për menaxhimin e riskut të bazuar në prova dhe mesazhe të mundshme kyçe që lidhen me aspektet e ndërveprimit njeri-kafshë-mjedis të ngjarjes ose kërcënimit të vlerësuar. Mund të propozohen opsione si për menaxhimin dhe komunikimet shumësektoriale, ashtu edhe për menaxhimin dhe komunikimet specifike për sektorin, por të harmonizuara.

Shembulli i menaxhimi të riskut është të kryhet një ushtrim simulimi për të vlerësuar reagimin ndaj rrezikut. Ndërsa shembull i komunikimit të riskut është një fushatë me mesazhin kryesor se mishi i gatuar plotësisht është i sigurt për t'u ngrënë.

Hapi 10

Dokumentimi i vlerësimit

Ekipi teknik mban shënime përgjatë tërë procesit të vlerësimit (Aneksi A, Hapat 6-8). Një anëtar i ekipit mban shënime dhe plotëson formularin sipas Aneksit C përgjatë gjithë diskutimit.

Dokumentimi i VPR-së është shumë i rëndësishëm. Ekipi duhet të jetë në gjendje të shqyrtojë në detaje procesin e të menduarit pas çdo hapi të vlerësimit të tyre të riskut dhe të dokumentojë në mënyrë specifike informacionin dhe opinionet e ekspertëve të përdorura dhe bazën për çdo vlerësim të probabilitetit dhe ndikimit të bërë. Kjo mundëson:

- arsyetim të mëvonshëm të vendimeve për vendimarrësit ose të tjerët;
- vlerësime të rreziqeve pasuese bazuar në të njëjtat kritere, veçanërisht nëse ka ndryshime në anëtarët e ekipit të VPR-së.

Raporti mund të përfshijë çdo shqetësim me shkrim ose ndryshime të rekomanduara në proces nga Ekipi, p.sh. mungesa e ekspertizës brenda ekipit, për çështje të caktuara.

Operacionalizimi i rezultateve të vlerësimit të riskut dhe hapat e mëtejshëm

Ekipi të gjitha rezultatet e VPR-së do ti paraqes në Institucionet përgjegjëse që kanë propozuar themelimin e ekipit për vlerësim të riskut me vendim të drejtuesit/es të institucionit/agjencisë/departamentit dhe komitetit për shëndetin human, animal dhe mjedisor “Një shëndet”.

Shumica e veprimeve të menaxhimit dhe komunikimit të riskut do të zbatohen si pjesë e përgjegjësiwe rutinë nga institucionet/ministritë e linjës të secilit sektor përkatës për mbikëqyrje, komunikim dhe reagim. Disa veprime dhe mesazhe do të jenë specifike për sektorin, ndërsa disa do të jenë të përbashkëta, por të gjitha janë të harmonizuara dhe nuk bien ndesh me të tjerat.

Institucionit/agjencitë/departamentet dhe komiteti për shëndetin human, animal dhe mjedisor “Një shëndet” do të:

- shqyrtojë opsionet e menaxhimit të riskut, arsyetimet dhe përparësitë nga rezultati i VPR-së;
- përcaktojë hapat e mëtejshëm, afatet kohore, rolet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e riskut dhe komunikimin e riskut;
- bjerë dakord mbi veprimet prioritare dhe ndërmerr hapat e mëtejshëm;
- vendosë për kohën për përsëritjen e ardhshme të vlerësimit të riskut;

Komiteti shqyrton raportin e VPR-së dhe çdo rezultat tjetër nga ekipi i VPR-së. Nëse është e nevojshme, ata mund të kërkojnë sqarime, rishikime ose analiza shtesë nga ekipi i VPR-së.

Komiteti Një shëndet, në konsultim me ekipin teknik, vendos se kur ekipi rimbledhet për përsëritjen e radhës, bazuar në urgjencën e situatës. VPR-të pasuese mund të kryhen shpejtë nëse është e nevojshme (p.sh. në një takim gjysmëditor ose nëpërmjet telefonit) dhe mund të mos ketë nevojë për takim shumëditor. Identifikimi dhe skicimi i rrugëve të riskut dhe pyetjet e vlerësimit të riskut shpesh mund të ripërdoren dhe kanë nevojë për rishikim vetëm nëse situata epidemiologjike ose korniza e riskut ndryshon. Një përsëritje tjetër e një VPR-së mund të ofrojë mundësinë për ekspertizë shtesë në ekip, e cila në situatën ideale do të konfirmohej nga komiteti “Një shëndet” ku raportet e mëhershme të VPR-së duhet të reflektojnë në vlerësimet pasuese të përbashkëta të riskut (VPR).

Shembull:

Ekipi teknik i VPR-së i propozoi komitetit “për shëndetin human animal dhe mjedis “Një shëndet” opsione për menaxhimin dhe komunikimin e riskut, gjatë kryerjes së një VPR-je për të adresuar rreziqet shëndetësore në ndërveprimin njeri-kafshë-mjedis të shkaktuara nga virusi i Ethes Hemorragjike Krime Kongo (EHKK).

Pyetja e riskut ishte “Cili është probabiliteti dhe ndikimi i të pasurit të paktën një banori të infektuar me Brucellozë, si pasojë e ekspozimit me lëngjet nga një kafshë e infektuar gjatë gjithë vitit?

Opsionet e menaxhimit të riskut për t’u marrë në konsideratë nga komiteti “Një shëndet”

Opsionet e menaxhimit afatshkurtër

Infektimi i kafshëve:

- Palët e interesit dhe fermerët duhet të marrin në konsideratë vaksinimin për të parandaluar shpërthimet.

Zbulimi i hershëm i shpërthimeve të Brucellozës në kafshë:

- Vendosja e mbikëqyrjes së integruar në kafshë edhe në nivel regjional me qëllim të ndërrmarjes së masave të kontrollit

Kontrolli i shpërthimeve të Brucellozës në kafshë:

- Zbatimi i pikave të kontrollit të kafshëve dhe karantina.

- Inspektimi dhe ekzaminimi i të gjitha kafshëve para ngarkimit në kamionë ose autorizimit për shitje.
- Rritja e nivelit të identifikimit, gjurmueshmërisë dhe informatave kthyesë

Parandalimi i infeksionit në fermë:

- Inkurajimi i përdorimit të pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale në fermë .
- Siguria dhe higjiena në objekt duhet të zbatohen

Opsionet e menaxhimit afatgjatë

Kontrolli i sëmundjes:

- Zbulimi i hershëm i shpërthimeve të Brucellozës tek kafshët:
- Zhvillimi i testeve diagnostikuese në pikat e kujdesit për zbulimin e shpejtë.

Kontrolli i shpërthimeve tek njerëzit

- Përditësimi dhe zbatimi i Inspektimit të qumështit dhe mishit në qendrat shitëse

Opsionet e komunikimit të riskut për t'u marrë në konsideratë nga Komiteti Një shëndet

- Fermerët dhe tregtarët e kafshëve duhet të trajnohen dhe të sensibilizohen për zbulimin e infeksioneve në nivel ferme duke raportuar shkallë të larta të aborteve spontane.
- Të zhvillohen mënyra për të komunikuar ndikimet në ekonomi dhe shëndet.
- Të rritet ndërgjegjësimi midis fermerëve mbi rrezikun e Brucellozës dhe përdorimin e duhur të pajisjeve mbrojtëse personale..

5. Aneket

Aneksi A. Vlerësimi i përbashkët i riskut

1. Titulli i vlerësimit

- Një përmbledhje e shkurtër e ngjarjes që vlerësohet, p.sh. "Vlerësimi i përbashkët i riskut (ngjarja, rrezik) në (vendndodhja, (muaji/viti))".

2. Vlerësimi i datës, kohës dhe vendit, datat e vlerësimit të mëparshëm të riskut

- Data, ora dhe vendi i vlerësimit

- Data e vlerësimit të fundit të riskut për këtë ngjarje

3. Pjesëmarrësit dhe ekspertiza

- Listoni emrat dhe ekspertizën e pjesëmarrësve.
- Identifikoni kryesuesin e vlerësimit të përbashkët të riskut (VPR).

4. Përmbledhja e ngjarjes

- Është një përmbledhje e shkurtër e ngjarjes ose rrezikut që vlerësohet.
- Përfshini një përshkrim të shkurtër se kush, çfarë, ku, kur, masat e marra deri më sot dhe informata të tjera relevante/kyçe.

5. Korniza e riskut

- Përkruani rrezikun, fushëveprimin, qëllimin dhe objektivat, siç përcaktohet nga grupi për vlerësim të përbashkët të riskut

6. Përmbledhja e vlerësimit

- Kjo është një "përmbledhje ekzekutive" e rezultateve të vlerësimit dhe interpretimit duke përfshirë pyetjet e vlerësimit të riskut dhe vlerësimet e probabilitetit, ndikimit dhe pasigurisë, së bashku me faktorët që kontribuojnë në këtë vlerësim dhe boshllëqet e të dhënave si dhe opsionet kryesore të menaxhimit/komunikimit.

7. Supozimet kryesore

(shih modulin 3: hapi 8.1 shqyrtimi i informacionit në dispozicion)

- Çdo supozim i përgjithshëm mbi të cilin bazohet VPR, veçanërisht në rastet kur informacionet rreth ngjarjes nuk janë në dispozicion
- Për shembull, "Ky vlerësim bazohet në supozimin se ekziston lidhje epidemiologjike e sëmundjes në popullatën e kafshëve dhe ate humane".

8. Rezultatet e detajuara të vlerësimit të riskut bazuar në pyetjet e vlerësimit të riskut (shih modulin 3: hapat 7-8)

- Plotësoni pjesën e mëposhtme për çdo pyetje të vlerësimit të riskut.

8A. Cili është probabiliteti dhe ndikimi i...?

- Siguroni vlerësimin nga pyetja e parë e vlerësimit të përbashkët të riskut.

Vlerësimi i probabilitetit A:

Vlerësoni probabilitetin për pyetjen e parashtruar gjatë vlerësimit të përbashkët të riskut.

- Arsyetimi për vlerësimin e probabilitetit A
 - Paraqitni si pika në mënyrë taksative, informacionin kryesor mbi të cilin bazohet ky vlerësim i probabilitetit;
 - Paraqitni çdo supozim të përdorur për të vlerësuar probabilitetin (p.sh. "Supozohet se ky virus ka të njëjtën prevalencë tek shpezët si gjatë shpërthimit të fundit", "Supozohet se virusi shkakton sëmundje të ngjashme tek shpezët si gjatë shpërthimit të fundit").
- Niveli i pasigurisë për vlerësimin e probabilitetit A Siguroni nivelin e pasigurisë për vlerësimin e probabilitetit.
- Arsyetimi për nivelin e pasigurisë lidhet me vlerësimin e probabilitetit A

Paraqitni boshllëqet kryesore të informacionit mbi të cilat bazohet ky nivel pasigurie (p.sh. "Nëntipi i virusit nuk është i disponueshëm"; "Nuk ka të dhëna të prevalencës mbi infeksionin tek shpezët").

Vlerësimi i ndikimit A:

Siguroni vlerësimin e ndikimit për pyetjet gjatë vlerësimit të përbashkët të riskut.

- Arsyetimi për vlerësimin e ndikimit A
 - Paraqitni informacionin kryesor mbi të cilin bazohet ky vlerësim i ndikimit.
 - Paraqitni çdo supozim të përdorur për të vlerësuar këtë ndikim (p.sh. "Supozohet se kontrolli i lëvizjes së kafshëve është efektiv").
- Niveli i pasigurisë për vlerësimin e ndikimit A
 - Paraqitni nivelin e pasigurisë për këtë vlerësim të ndikimit.
- Arsyetimi për nivelin e pasigurisë që lidhet me vlerësimin e ndikimit A
 - Paraqitni, si pika në mënyrë taksative boshllëqet kryesore të informacionit në të cilat bazohet ky nivel pasigurie (p.sh. "Nëntipi i virusit nuk është i disponueshëm"; "Nuk ka të dhëna të prevalencës mbi infeksionin tek shpezët").

Matrica e rrezikut për pyetjet gjatë vlerësimit të përbashkët të riskut A

Probabiliteti	I lartë				
	Mesatar				
	I ulët				
	I parëndësishëm				
		I parëndësishëm	I vogël	Mesatar	I rëndë
		Ndikimi			

Plotësoni matricën nga pjesa e vlerësimit të probabilitetit dhe ndikimit në pyetjet për vlerësim të përbashkët të riskut.

d) Interpretimi teknik për vlerësimin të përbashkët të riskut A

Përmbledhje e përfundimeve bazuar në vlerësimin e përbashkët të riskut dhe nivelin e pasigurisë, duke përfshirë informacionin kyç dhe boshllëqet e informacioneve të rëndësishme. Disa opsione për nivelin e menaxhimit të riskut dhe mesazhet e nevojshme për komunikim të riskut të cilat mund të përfshihen (shih modulin 3: hapi 8, Shembull).

8B. Cili është probabiliteti dhe ndikimi i...?

Siguroni vlerësimin e parë të përbashkët të riskut bazuar në pyetjen e dakorduar

Vlerësimi i probabilitetit B:

Vlerësoni probabilitetin për pyetjen e parashtruar gjatë vlerësimit të përbashkët të riskut.

a) Arsjetimi për vlerësimin e probabilitetit B

- Paraqitni si pika në mënyrë taksative, informacionin kryesor mbi të cilin bazohet ky vlerësim i probabilitetit.

Paraqitni çdo supozim të përdorur për të vlerësuar probabilitetin (p.sh. "Supozohet se ky virus ka të njëjtën prevalencë tek shpezët si gjatë shpërthimit të fundit", "Supozohet se virusi shkakton sëmundje të ngjashme tek shpezët si gjatë shpërthimit të fundit").

b) Niveli i pasigurisë për vlerësimin e probabilitetit B Siguroni nivelin e pasigurisë për vlerësimin e probabilitetit.

c) Arsjetimi për nivelin e pasigurisë që lidhet me vlerësimin e probabilitetit B

Paraqitni boshllëqet kryesore të informacionit mbi të cilat bazohet ky nivel pasigurie (p.sh. "Nëntipi i virusit nuk është i disponueshëm"; "Nuk ka të dhëna të prevalencës mbi infeksionin tek shpezët").

Vlerësimi i ndikimit B:

Siguroni vlerësimin e ndikimit për pyetjet gjatë vlerësimit të përbashkët të riskut.

a) Arsjetimi për vlerësimin e ndikimit B

- Paraqitni informacionin kryesor mbi të cilin bazohet ky vlerësim i ndikimit.

b) Niveli i pasigurisë për vlerësimin e ndikimit B

- Paraqitni nivelin e pasigurisë për këtë vlerësim të ndikimit.

c) Arsjetimi për nivelin e pasigurisë që lidhet me vlerësimin e ndikimit B

- Paraqitni si pika në mënyrë taksative boshllëqet kryesore të informacionit në të cilat bazohet ky nivel pasigurie (p.sh. "Nëntipi i virusit nuk është i disponueshëm"; "Nuk ka të dhëna të prevalencës mbi infeksionin tek shpezët").

Matrica e rrezikut për pyetjet gjatë vlerësimit të përbashkët të riskut B

Probabiliteti	I lartë				
	Mesatar				
	I ulët				
	I parëndësishëm				
		I parëndësishëm	I vogël	Mesatar	I rëndë
		Ndikimi			

Plotësoni matricën nga pjesa e vlerësimit të probabilitetit dhe ndikimit në pyetjet për vlerësim të përbashkët të riskut.

d) Interpretimi teknik i pyetjes B të vlerësimit të rrezikut

Jepni një përmbledhje të përfundimeve bazuar në vlerësimet dhe nivelin e pasigurisë, duke përfshirë boshllëqet kryesore të informacionit dhe informacionit ishin të rëndësishme. Disa opsione për nivelin e menaxhimit të rrezikut dhe mesazhet e nevojshme të komunikimit të rrezikut mund të përfshihen (shih modulën 3: hapi 8, Shembull).

8C, 8D, etj Cili është probabiliteti dhe ndikimi i...?

Siguroni vlerësimin e parë të përbashkët të riskut bazuar në pyetjen e dakorduar

9. Interpretimi i përgjithshëm teknik

Siguroni një përmbledhje të përfundimeve nëse ka nevojë si plotësim i interpretimit teknik në çdo pyetje të vlerësimit të përbashkët të riskut.

10. Informacioni i nevojshëm (shih modulën 3: hapi 8.2, seksioni "Identifikimi i boshllëqeve të informacionit")

- Përfshini informacionin specifik të nevojshëm për të siguruar vlerësimin e probabilitetit dhe ndikimit dhe për të ulur pasigurinë për vlerësimin e radhës të VPR.
- Mund të përfshijë identifikimin e burimeve të mundshme të këtij informacioni.

11. Opsionet e menaxhimit të riskut për shqyrtim nga komiteti (shih modulën 4: hapi 9)

Përmbledhni opsionet e propozuara për menaxhim të riskut, veçanërisht ato me prioritet

12. Opsionet e komunikimit të riskut për shqyrtim nga komiteti (shih modulën 4: hapi 9)

Përmbledhni opsionet e propozuara për komunikim të riskut, veçanërisht ato me prioritet.

13. Çështjet tjera të lidhura me të dhënat

Për shembull, çështje të konfliktit ose mos marrëveshjet midis ekspertëve.

14. Hapat e ardhshëm dhe rekomandimet

Përmbledhni hapat për të mbledhur të dhënat me interes siç janë identifikuar në seksionin 10 më sipër të këtij modeli të raportit të VPR-së, duke përfshirë vlerësimet e riskut specifik për sektor.

15. Koha e propozuar për vlerësimin e ardhshëm të përbashkët të riskut për këtë ngjarje

Caktoni kohën për vlerësimin e rradsës ose arsien për përsëritjen e VPR-së bazuar në urgjencën ose faktorë të tjerë (p.sh. mbledhja e të dhënave).

Anekset:

Mund të përfshijë dokumente mbështetëse sipas nevojës:

- Të dhënat/informacionet e përdorura;
- Skicimi i rrugës së rrezikut;
- Rezultatet e vlerësimeve të riskut specifik për sektor.

--

Aneksi B. Informacioni i nevojshëm për vlerësim të përbashkët të riskut

Të dhënat epidemiologjike dhe klinike

1. Informacionet nga pjesa humane

- Numri i rasteve/ngjarjeve dhe popullata e prekur, data e fillimit të ngjarjes dhe magnituda e kësaj ngjarjeje
- Mosha, gjinia, të ekspozuar;
- Koha, periudha e inkubacionit, përhapja e infeksionit;
- Shenjat klinike, shkalla e vdekshmërisë dhe ashpërsia, popullatat në rrezik;
- Historia e trajtimit, rezultati;
- Historia e udhëtimit;
- Numri i rasteve të tjera, të dyshuara ose të konfirmuara, kontakte të ngushta ose punonjës të kujdesit shëndetësor;
- Përhapja e infeksionit dhe potenciali për përhapje nga njeriu te njeriu;
- Raste të ngjashme në vend/rajon (të dhënat e fundit dhe historike).

2. Informacionet nga pjesa animale

- Aktiviteti i sëmundjes në kafshë në vend/rajon (speciet, popullatat e prekura, numri i rasteve dhe koha/vendndodhja, data e fillimit të ngjarjes dhe magnituda, incidenca/prevalenca);
- Rezervuari/burimi i infeksionit;
- Sistemet e prodhimtarisë së kafshëve që lidhen me ekspozimin;
- Informacioni specifik i zinxhirit, duke përfshirë lëvizjet brenda një vendi dhe përtej kufijve dhe informatat nga monitorimi ndërkufitar i zinxhirit.

3. Informacionet e përgjithshme dhe të ndërveprimit

- Burimet e ekspozimit të mundshëm (njeriu, kafshë, mjedisi);
- Sezonaliteti ose efekte të tjera të njohura p.sh. sjellja dhe praktikat sezonale dhe kulturore (festivalet, sezonet e gjuetisë,);
- Aktivitetet ekonomike që zgjerojnë ndërveprimin njeri-bagëti-kafshë të egra (p.sh. gjuetia, ekoturizmi, ndërhyrja bujqësore)
- Mjediset e kontaminuara;
- Vektorët dhe amvisët/nikoqiri, nëse është e nevojshme;
- Futja ose zhvendosja e specieve të kafshëve të egra për ruajtje, nëse është e nevojshme;
- Çështjet e sigurisë ushqimore, nëse është e nevojshme.

4. Patogjeni/Rreziku

- Agjent human/animal: identifikimi/konfirmimi laboratorik, disponueshmëria, nëntipit/kladës/llojit/serotipit, ndjeshmërisë antimikrobike, mutacioneve gjenetike;
- Ndryshimet në virus (antigjeniteti, gjenetika ose ngjarjet e riorganizimit);
- Qarkullimi normal i nëntipit/kladës/llojit/serotipit në rajon/globalisht;
- Përhapja tek dhe midis njerëzve ($R_0,6$ nëse dihet);
- Rrugët e përhapjes tek kafshët;
- Përgjigja e dozës, nëse është e rëndësishme;
- Imuniteti i mundshëm i popullsisë (kafshët dhe njerëzit);
- Disponueshmëria e vaksinimit tek kafshët;
- Infektim pavarësisht vaksinimit.

5. Konteksti

- Ekologjia/klima;
- Prodhimi dhe marketingu i kafshëve, përqindja e familjeve që mbajnë kafshë, shfrytëzimi i tregut të kafshëve të gjalla në zonat e prekura;
- Lloji i hulumtimit të kryer deri më sot;
- Efikasiteti/ efektiviteti i sistemeve të mbikëqyrjes tek njerëzit;
- Kapaciteti spitalor dhe kapaciteti i gjithmbarshëm;
- Efikasiteti/efektiviteti i sistemeve të mbikëqyrjes në kafshë;
- Masat në vend (dhe zbatimi, pasojat), aktivitetet e hulumtimit/kontrollit dhe niveli/shpërndarja dhe zbatimi;
- Çështjet kulturore, sjellja e popullatës për kujdesi shëndetësor, qasja dhe festat;
- Situata politike, çështjet e sigurisë;
- Pasojat ekonomike dhe sociale;
- Lëvizja ndërkufitare e popullatës.

R_0 : shkalla bazë e riprodhimit - një masë për potencialin e transmetimit të patogjenëve/sëmundjeve

Aneksi C. Korniza e riskut

Modeli i kornizës së riskut për të tre sektorët, për vlerësim të përbashkët të riskut.

Kjo formë mbështet komitetin "Një shëndet" për vlerësim të përbashkët të rrezikut për të kornizuar vlerësimin e përbashkët të rrezikut në mënyrë që vlerësimi dhe opsionet e lidhura me menaxhimin dhe komunikimin e riskut të përqendrohen në shqetësimet specifike aktuale të vendimarrësve. Bazuar në këtë kornizë të riskut, Ekipi i VPR-së identifikon pyetjet e vlerësimit të riskut për t'u adresuar dhe ofron opsione të përshtatshme dhe relevante të menaxhimit dhe komunikimit të riskut.

Jepni sa më shumë informacione specifike që të jetë e mundur.

1. Rreziku

- (1) Rreziku, sëmundja zoonotike prioritare ose ngjarja shqetësuese e lidhur me sëmundjet zoonotike për t'u vlerësuar

- (2) Cili është shqetësimi kryesor i vendimarrësve në lidhje me këtë rrezik?

2. Fushëveprimi

Në shumicën e rasteve, fushëveprimi i VPR-së do të jetë "rreziqet shëndetësore në ndërveprimin njeri-kafshë-mjedis të paraqitura nga rreziku i paraqitur si më lartë" (duke specifikuar gjithashtu zonën gjeografike ose nivelin administrativ p.sh.

- (3) A është ky qëllimi i vlerësimit të propozuar?

Po

Jo

- (4) Nëse jo, cili është qëllimi?

- (5) Cilat janë zonat gjeografike dhe niveli administrativ i prekur?

(6) A ka aspekte të tjera kritike për t'u përfshirë në fushëveprim (referojuni, Moduli 3: Hapi 5)?

Po Jo

(7) Nëse po, aspekte të tjera që duhet të merren parasysh

3. Qëllimi

Në përgjithësi, qëllimi (arsyeja për të bërë vlerësimin) i çdo vlerësimi të riskut është të mbështesë zbutjen e rreziqeve.

(8) A është ky qëllimi për vlerësim të riskut?

Po Jo

(9) Nëse jo, cilat janë qëllimet shtesë ose më specifike?

4. Objektivi kryesor

Në përgjithësi, objektivi kryesor (qëllimi ose rezultati i dëshiruar) është të sigurojë një bazë për vendimet për menaxhim dhe komunikim të riskut.

(10) A është ky objektivi kryesor për vlerësim të riskut?

Po Jo

(11) Nëse jo, cilat janë objektivat shtesë ose më specifike?

5. Ekipi i VPR-së

(12) Cilat agjenci ose institucione qeveritare (ose joqeveritare) kanë ekspertizën dhe informacionin e kërkuar për këtë fushëveprim siç janë përshkruar më sipër?

(13) A ka ndonjë palë tjetër të interesit që duhet të informohet ose përfshihet?